

Markes “Amaranta dhe vdekja”

Njëqind vjet vetmi

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Në çastet e fundme të jetës Amaranta nuk e ndjeu veten aspak si të dështuar në jetë...

Pse në fragment supozohet se Amaranta mund ta ndjente veten të dështuar në jetë?

Mundohuni të analizoni kuptimet e fjalisë: *Vdekja i qe shfaqur vite më parë.*

Gjeni dhe tregoni detajet me të cilat tregohet vdekja në fragment.

Çfarë u bën përshtypje nga mënyra si jepet vdekja (detajet që gjetët)?

Në verandë hynin e dilnin edhe njerëz të tjerë, por nuk e pikasnin, ndonëse Vdekja ishte aq reale...

Jepni një shpjegim të faktit që vdekja nuk shihet prej të tjerëve, veç Amarantës.

-shënime-

Që të rrekej sa më gjatë me përgatitjen e rrobave, Amaranta porositi fill liri dhe endi vetë pëlhurën e qefinit në tezgjah. Dhe e endi me aq merak, sa iu deshëm plot katër vjet për ta mbaruar. Pastaj iu vu qëndisjes dhe sa më shumë që i afrohej fundit të pashmangshëm, aq më shumë i ngulitej bindja se vetëm një mrekulli mund ta shpëtonte nga ky fatalitet.

Kë personazh të mitologjisë antike u kujton Amaranta me përgatitjen dhe qepjen vetë të rrobave të vdekjes? Cili është ndryshimi i saj nga ky personazh? Gjeni detaje për të ilustruar mendimin.

Amaranta përgatit me merak dhe madhështi rrobat e saj të vdekjes, pëlhurën, qëndisimat (të atillë qëndisimë nuk ishte parë ndonjëherë syri i njeriut), qëllimi i saj i vetëm është kjo përgatitje, porositi arkivolin si fustan nusërie etj.

Çfarë u kujtojnë gjithë përgatitjet e Amarantës për të pritur vdekjen?

I hodhi një vështrim me sytë e mendjes së kaluarës, e qortoi veten që e zinin të dridhurat kur kujtonte erën e livandos së Pietro Krespit, e kuptoi edhe honin e vetmisë gjatë tërë kësaj kohe.

A është penduar Amaranta që refuzoi propozimin e P. Krespit dhe që në fund u bë shkaktare për vetëvrasjen e tij? Ilustro mendimin me fjali nga fragmenti.

[prifti] Bëri si bëri dhe vendosi ta provonte fatin, mos ajo tregohej e gatshme të rrëfehej, që s'e kishte bërë kurrë gjatë më se njëzet vjetëve. Amaranta ia preu shkurt: nuk kishte nevojë për asnjë ndihmesë kishtare; ndërgjegjen e kishte qelibar.

Nisur nga ky fragment, vërtetoni që Amaranta nuk është penduar as për refuzimin e dashurisë, por as për shkaktimin e vdekjes së Krespit.

-shënime-

Jepni mendimin tuaj pse Amaranta merr përsipër të çojë letrat tek të vdekurit?

Merrni parasysh edhe nëntekstin e komunikimit të Amarantës me botën e të vdekurve.

I hodhi një vështrim me sytë e mendjes së kaluarës, e qortoi veten që e zinin të dridhurat kur kujtonte erën e livandos së Pietro Krespit, e kuptoi edhe honin e vetmisë gjatë tërë kësaj kohe.

Sipas pjesës së fundit të fjalisë, cili është rezultati i refuzimit të dashurisë?

Përcaktoni fajtorin që vetmia e Amarantës është e tmerrshme (honi i vetmisë), shndërrohet në një burim vuajtjesh për të dhe në perversitet (vetëngujim brenda katër mureve).

Çfarë arrin të përcjellë tek lexuesi Markezi me fjali të tipit:

*...pa pikën e tronditjes shpalli se do të vdiste atë mbrëmje...
...e kish porositur t'i merrte masën e arkivolit, si të ishte fjala për masën e ndonjë fustani...*

Analizë e marrëdhënieve nënë-bijë (Ursula-Amaranta).

Si paraqitet e ëma e Amarantës, Ursula në këto momente? Shpjegoni pse?

Si sillet ajo gjatë gjithë kohës?

A ka dhimbje si nënë që po i vdes e bija?

-shënime-

A është në natyrën e Amarantës deklarata e saj para vdekjes:

Ta dinë të gjithë... që Amaranta Buendia po ikën nga kjo botë e paprekur, ashtu siç erdhi?

Nisur nga kjo deklaratë e saj dhe nga fakti që kërkon të marrë letrat për të vdekurit a mund ta etiketojmë Amarantën si kryeneçe?

Shpjegoni lidhjen e varësisë që krijohet mes Amarantës, vetmisë dhe vdekjes.

A mund të konsiderohet vdekja si shpëtim për Amarantën?